



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.121/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Kymete Kicaj dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik koalicionit AAK-PSD, me seli në Deçan, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 30.09.2019, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, ndërsa subjektit politik koalicionit AAK-PSD, i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 2,500.00 (dymijë e pesëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Institutit Demokratik i Kosovës (KDI) me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 28.09.2019, me të cilën pretendon sene një takim të mbajtur nga koalicioni AAK-PSD ka hasur në disa fëmijë me materiale zgjedhore, me logo të koalicionit AAK-PSD. Paraqitësi i ankesës pretendon se me këtë është bërë shkelje e Kodit të Mirësjelljes.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur disa fotografi, nga vendi ku ka ndodhur shkelja e kodit të mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët.

Në përgjigjen në ankesë koalicioni AAK-PSD deklaroi se në ankesë nuk është cekur se për cilin takim dhe për cilën komune behet fjalë. Po ashtu në përgjigje në ankesë theksohet se koalicioni AAK-PSD ka bërë thirrje të gjitha strukturave dhe mbështetësve ta respektojnë ligjin në fuqi dhe kodin e mirësjelljes. Përgjigjes në ankesë si provë i ka bashkangjitur fotografi nga publikimi në media të thirrjes së AAK-PSD për respektimin e rregullave zgjedhore.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli nga fotot e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se në takimin e mbajtur ka hasur ne disa fëmijë me materiale zgjedhore me logo te koalicionit AAK-PSD, veprim ky që është në kundërshtim me zgjedhjet e nenin 2 pika 5.3 e Riformular pika b), c) dhe d), të Rregullës Zgjedhore nr.20/2019 mbi ndryshimin dhe plotësimin e rregullores zgjedhore nr.13/2013 të KQZ-së, që në rastin konkret, personat nën 18 vjet bartin material promovues gjatë fushatës zgjedhore, ku të njëjtit kanë bartur flamuj me logo të AAK-së.

Paneli me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik koalicioni AAK-PSD, nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se të njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për t'u përgjigjur, ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre, nuk e kanë pranuar shkeljen, me arsyetimin se nuk është cekur se për cilin takim dhe për cilën komune behet fjalë. Pretendime e tilla Paneli i vlerësoi si të paqëndrueshme, pasi që siç shihet nga fotografit e ofruara si dëshmi ku disa fëmijë bartin flamuj te koalicionit AAK-PSD, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi. Me këtë vendim dhe shqiptim të gjobës paneli vendosi se do të ndikon te subjekti politik që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 121/2019 më datën 30.09.2019

Kryesuese e Panelit
Gylene Sylejmani



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.